



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 590/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Ferit Osmani kryesues, Vllastmir Dimic dhe Nehat Idrizi anëtarë, përkatësi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) paraqitur kundër kryesuesit të vendvotimit (VV) nr. 1920e/03, Rrahman Veseli, në lidhje me parregullsi gjatë procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 15.12.2010, mori:

VENDIM

HIDHET poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV)

ARSYETIMI

Më datë 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga LVV paraqitur kundër kryesuesit të VV nr. 1920e/03, Rrahman Veseli, në të cilën pretendohet se “me datë 12.12.2010 në VV në fjalë pothuajse tërë ditën nuk ka punuar llampa për kontrollimin e ngjyrës së padukshme në gishtërinjtë e votuesve. Vëzhguesja e LVV-se Arta Abazi ka kërkuar nga kryesuesi i vendvotimit të lartcekur, që të mos lejoj që të votohet, mirëpo kryesuesi i VV-se nuk ka ndërmarrë asnjë veprim dhe si rezultat ka vepruar në kundërshtim me nenin 11.1 të Rregullës Zgjedhore 09/2009”.

Në mbështetje të pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë materiale, përveç se ka siguruar numrin e telefonit të Artës Abazit, në cilësinë e vëzhgueses së LVV-se dhe dëshmitare në vend ngjarje.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, specifikon si më poshtë:

59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji;

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 *“Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo at të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie”.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e palejuar

PZAP-i vlerëson se ankesa e LVV-se paraqitur përkundrejt kryesuesit të vendotimit 1920e/03 Rrahman Veseli, është jashtë juridiksionit të PZAP, për shkak se KQZ është organi i cili merret me funksionalizimin dhe organizimin e zgjedhjeve duke përfshirë edhe përdorimin e detektorëve gjatë procesit të zgjedhjeve, fakt ky që konfirmohet nëpërmjet Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2009. Prandaj për këtë arsye dhe në pajtim të dispozitave ligjore të cekura më lartë si dhe në pajtim të nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 590/2010 më datën 15.12.2010.

